

VENDIM
Nr.483, datë 25.7.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË KUSHTEVE DHE KRITEREVE PËR
DHËNIEN E STATUSIT “TEATËR METROPOLITAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 30 të ligjit nr.9631, datë 30.10.2006 “Për artin skenik”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e statusit të veçantë “Teatër metropolitan”, në kuptim të nenit 30 të ligjit nr.9631, datë 30.10.2006 “Për artin skenik”, me urdhër të Kryeministrit, pas propozimit të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, një institucioni të artit skenik vendor, që plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuar në këtë vendim.

2. Procedurat për të fituar statusin “Teatër metropolitan”, janë si, më poshtë vijon:

a) Paraqitja e kërkesës, së bashku me dokumentacionin e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, dhe me një historik të veprimtarisë së institucionit të artit skenik vendor, te Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, ku ka selinë ky institucion.

b) Shqyrtimi i kërkesës dhe i dokumentacionit shoqërues nga struktura përkatëse e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, e cila pasi verifikon nëse institucioni plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi dhe vërtetësinë e dokumentacionit, i paraqet një raport, me shkrim, Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, ku shprehet për përfitimin ose jo të këtij statusi.

Afati nga depozitimi i kërkesës deri në shqyrtimin përfundimtar të saj është 45 ditë.

c) Nëse kërkesa miratohet, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve i propozon Kryeministrit dhënien e statusit të veçantë “Teatër metropolitan”.

3. Kushtet dhe kriteret, që duhet të plotësojë një institucion publik i artit skenik vendor për përfitimin e statusit të veçantë “Teatër metropolitan”, janë si më poshtë vijon:

a) Të ketë zhvilluar veprimtari artistike si teatër profesionist, për jo më pak se 55 vjet.

b) Të ketë fituar titullin më të lartë ose njërin nga tri çmimet e para të festivalit kombëtar.

c) Të ketë marrë pjesë në veprimtari ndërkombëtare dhe të jetë vlerësuar me çmime.

ç) Të ketë shfaqur mbi 200 premiera.

d) Qarku ku e ka selinë teatri të ketë jo më pak se 300 000 banorë.

4. Ngarkohet Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha